



URDHRI I MJEKEVE TE SHQIPERISE

KESHILLI RAJONAL FIER

Deklarate

Nuk eshte hera e pare qe mjeket e Spitalit Rajonal Fier,ashtu sic edhe ne cdo Spital tjeter,jane dhunuar nga persona te pandergjegjshem !

Rasti me i fresket eshte ngjarja e mbremshme ku rreth ores 15:30 prane Spitalit Rajonal Fier,pikerisht ne repartin e Urgjences,jane paraqitur tre persona ne gjendje te dehur.

Pasi personeli mjeksor, ka konstatuar se personat ishin ne gjendje te dehur, menjehere moren masa per ti trajtuar me medikamente per te tilla raste.

Pikerisht ,ne keto momente, mjeku i Urgjences Dr.Klodian Goga dhe personeli infermieror, jane qelluar me grushta nga tre personat e mberitur.

Menjehere eshte njoftuar edhe policia,.te cilet kane kryer veprimet e tyre ligjore duke i shoqeruar dhunuesit e mjekut dhe personelit ne polici . Pas kesaj,mjeku i demtuar dhe personeli kane bere denoncimin ne Rajonin e Policise se Fierit.

Keshilli Rajonal i Urdherit te Mjekeve Fier,e denon kete akt kriminal dhe kerkojme qe fajtoret te dalin para ligjit .

Nuk eshte here e pare qe personeli i mjekeve te ketij Spitali.dhunohen nga persona te pandergjegjshem dhe imoral.

Eshte e papranueshme qe Mjeket te cilet punojne papushim me profesionalizem per ti sherbyer me se miri qytetareve,te dhunohen barbarisht.

Mjeket me shpirtin e tyre human ,shpetojne jete njerezish!

Urdheri i Mjekeve gjithmone do te jete ne krah te mjekeve duke i mbeshtetur fuqishem ne punen humane qe ata bejne cdo dite!

FALEMINDERIT!

Dr.Besnik Brahimaj

President i Keshillit Rajonal Urdhrit Mjekeve Fier